Paulla e taksës e paguar

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**DHOMA VENDORE E NOTERËVE TIRANË**
**Nr. 966 Rep.**
**Nr. 268 Kol.**

**KONTRATË SHITJE E KUOTAVE TË KAPITALIT**

**te Shoqërisë** *"DELTA Med " Sh.p.k.*

Në Tiranë, sot më datën 27 /02 /2020 (dymijë e njëzet), përpara meje Noterit, Gjergj Kongoli, Noter i Dhomës se Noterive Tirane, me adresë në Rrugën: "Kont Urani" Nr. 3, u paraqitën personalisht palët e poshtëshënuara për lidhjen e kësaj Kontrate:

**1. Z. Eduard CURRAJ,** shtetas shqiptar, i biri i Gjonit, i datëlindjes 13.10.1973, lindur ne Shkoder dhe banues në Tirane Rruga e Kavajes, E4, Shk.5, identifikuar me letërnjoftim nr. H31013028R, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, në cilësinë e Ortakut të Shoqërisë "DELTA Med" sh.p.k., zotërues në masën 50 % të kapitalit të shoqërisë, *këtu e më poshtë referuar si **"Shitësi I"***

**MARJANA CURRAJ,** atësia Nikë, lindur me 11.02.1979 ne Ivanaj, Shkoder dhe banuese ne Tirane Rruga e Kavajes, E4, Shk. 5, identifikuar me letërnjoftim nr. H95211035K, madhore dhe me zotësi te plota juridike për te vepruar, *këtu e më poshtë referuar si **"Dhenese Pelqimi"***

**2. Z. Dorian SADIKU,** shtetas shqiptar, i biri i Tahirit, i datëlindjes 20.06.1979, lindur ne Shkoder dhe me banues në Tirane, Bulevardi Gjergj Fishta, Pallati Selmani, identifikuar me letërnjoftim nr. H90620115D, person madhor e me zotësi të plotë juridike për të vepruar, në cilësinë e Ortakut të Shoqërisë "DELTA Med" sh.p.k., zotërues në masën 50 % të kapitalit të shoqërisë, *këtu e më poshtë referuar si **"Shitësi II"***

**JORIDA JUBANI**, atësia Adem, lindur me 04.06.1980 ne Shkodër dhe banuese ne Tirane, Bulevardi Gjergj Fishta, Pallati Selmani, identifikuar me Letërnjoftim ID Nr. I05604127T,

madhore dhe me zotësi te plota juridike për te vepruar, *këtu e më poshtë referuar si "Dhenese Pelqimi"*

dhe

**Shoqëria tregtare "Pharma One" shpk,** regjistruar pranë Qëndrës Kombëtare të Biznesit, me NIPT K72228008B, me adresë Kilometri 6, Autostrada Tiranë - Durrës, Pranë Fabrikës Prodhimit të Mobiljeve, Kashar, Tiranë, përfaqësuar nga Administratori **Z. Ben PETANI**, shtetas shqiptar, i biri i Spiros, lindur me 22.03.1967 ne Himare dhe banues ne Tirane, Njesia Bashkiake Nr. 10, Rruga e Kavajes, identifikuar me letërnjoftim nr.G70322160R, *këtu e më poshtë referuar si "Blerësi"*

Të cilët shprehën vullnetin e tyre të lirë për të lidhur kontratën e mëposhtme dhe ranë dakord për përmbajtjen e kontratës ndërmjet tyre, si më poshtë vijon:

**Preambula:**

*Duke qënë se Z. Eduard CURRAJ dëshiron të shesë 1 kuote qe perben 50 % të pjesëve të kapitalit themeltar që ai zotëron në shoqërinë tregtare "DELTA Med" Sh.p.k., regjistruar në Qëndrën Kombëtare të Biznesit me NIPT L78513201T;*

*Duke qënë se Z. Dorian SADIKU dëshiron të shesë 1 kuote qe perben 50 % të pjesëve të kapitalit themeltar që ai zotëron në shoqërinë tregtare "DELTA Med" Sh.p.k., regjistruar në Qëndrën Kombëtare të Biznesit me NIPT L78513201T;*

*Duke qënë se Shoqëria Tregtare "Pharma One" shpk, regjistruar pranë Qëndrës Kombëtare të Biznesit, me NIPT K72228008B dëshiron të blejë totalin e mësipërm 100 % të kuotave të kapitalit themeltar të shoqërisë tregtare "DELTA Med" Sh.p.k., që zotërojnë Z. Eduard CURRAJ dhe Z. Dorian SADIKU;*

*Duke qënë të vetëdijshëm për rëndësinë e veprimeve të tyre, si dhe në përmbushje të parashikimeve të Ligjit Nr.9901/2018, i ndryshuar, "Për tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" si dhe Statutit të Shoqërisë Tregtare "DELTA Med" Sh.p.k., palët e mësipërme vendosin të lidhin këtë kontratë në përputhje me kushtet si më poshtë.*

**Neni 1**
**Kushtet e Kontratës**

1.1 Në lidhjen e kësaj Kontrate ekziston pëlqimi i palëve në marrjen përsipër të detyrimeve përkatëse, shkaku i ligjshëm në të cilin mbështeten detyrimet, dhe objekti që formon lëndën e kontratës.

1.2. Kontrata quhet e vlefshme meqënëse palët kanë shfaqur dhe shprehur në mënyrë të ndërsjelltë vullnetin e tyre, duke u marrë vesh për të gjitha kushtet thelbësore të saj.

1.3. Në ketë Kontratë, palët shprehin dhe garantojnë që shkaku ligjor i lidhjes së saj nuk është i paligjshëm, nuk vjen në kundërshtim me ligjin, rendin publik si dhe Kontrata nuk shërben si mjet për të shmangur zbatimin e një norme të legjislacionit shqiptar.

**Neni 2**
**Qëllimi i Kontratës**

2.1 Qëllimi i kësaj Kontrate është transferimi i pronësisë kundrejt pagesës, të Kuotave të Kapitalit Themeltar të Shoqërisë Tregtare "*DELTA Med*" *Sh.p.k.*, që zotërojnë Shitësit, në favor të Blerësit.

2.2. Kjo Kontratë shërben për përcaktimin e kritereve, procedurave dhe mënyrave të transferimit të kësaj pronësie, si dhe pagesat përkatëse në lidhje me këtë transferim.

2.3. Me anë të këtij veprimi juridik, palët synojnë të krijojnë një marrëdhënie juridike ndërmjet tyre, e cila mbështetet në parimet e ndërshmërisë, ligjshmërisë dhe besimit reciprok ndërmjet palëve.

2.4. Në përcaktimin e kushteve, Palët në kontratë përcaktojnë lirisht përmbajtjen e saj, dhe angazhohen të kryejnë veprimet e tyre brënda kufijve të vendosura nga legjislacioni në fuqi dhe nga përmbajtja e kësaj kontrate.

**Neni 3**

**Objekti i Kontratës**

3.1. Objekti i kësaj Kontrate është i mundshëm, i ligjshëm, dhe i përcaktueshëm nga Palët nëpërmjet kësaj Kontrate, si dhe konsiston në Kuotat e Kapitalit Themeltar të Shoqërisë Tregtare *"DELTA Med" Sh.p.k.*, kundrejt vlerës së shitjes së tyre.

3.2. Me anë të kësaj Kontrate, Shitësit detyrohen t'i japin dhe ti kalojnë Blerësit 100 % të Kuotave të Kapitalit Themeltar që ata zotërojnë tek Shoqëria Tregtare *"DELTA Med" Sh.p.k.*, secili nga 50 % të pjesëve te kapitalit që zotërojnë, kundrejt shpërblimit të caktuar në këtë Kontratë.

3.3. Blerësi merr përsipër t'i paguaj Shitësësve, brenda nje afati 10 dite, shumën prej **64.763.670,00 Leke (gjashtedhjete e kater miljone e shtateqind e gjashtedhjete e tremije e gjashteqind e shtatetedhjete leke)**, kundrejt transferimit të pronesise së 100 % të pjeseve të Kapitalit Themeltar që ata zotërojnë në Shoqërinë *"DELTA Med" Sh.p.k.*

3.4. Shuma e mesiperme, do te ndahet ne menyre proporcionale mes ortakeve ekzistues pas nenshkrimit te kesaj kontrate: *50 % per Z. Eduard CURRAJ dhe 50 % per Z. Dorian SADIKU.*

3.5. Si rezultat i kësaj Kontrate, Blerësi do të mund të ushtrojë të njëjtat të drejta në Shoqërinë "*DELTA Med" Sh.p.k.*, për të cilat ishin titullarë Shitësit.

3.6. Blerësi heq dorë nga Dividendi i vitit 2019, i cili i takon shitësve sipas pjesëve të zotëruara para shitjes.

**Neni 4**

**Çmimi i shitjes dhe Procedura për Shlyerjen e Detyrimit**

4.1 Vlera e shitjes se pjeseve te kapitalit, eshte percaktuar me vullnetin e lire te paleve, ne shumen prej **64.763.670,00 Leke (gjashtedhjete e kater miljone e shtateqind e gjashtedhjete e tremije e gjashteqind e shtatetedhjete leke),** pagese e cila duhet te realizohet brenda nje afati 10 ditor.

4.2 Vlera e shitjes se kuotave te kapitalit do te depozitohet, me nënshkrimin e këtij akti, ne llogarine bankare e shitësave, për efekt të përmbushjes së detyrimeve te kësaj Marrëveshje, do të jetë si më poshtë vijon:

4.2.1 Vlera prej **32.381.835,00 Leke (tridhjete e dy miljon e treqind e tetedhjete e njemije e tetëqind e tridhjete e pese leke)** do te depozitohet ne llogarine bankare te shitësit Eduard Gjon Curraj:

Banka: -Raiffesen Bank Sh.a.
Nr. i Llogarise: 1401133488
Iban: AL3920251002000000 1401133488

4.2.2 Vlera prej **32.381.835,00 Leke (tridhjete e dy miljon e treqind e tetedhjete e njemije e tetëqind e tridhjete e pese leke)** do te depozitohet ne llogarine bankare te shitesit Dorian Tahir Sadiku

Banka: -Raiffesen Bank sh.a.
Nr. i Llogarise: 1401699476

Iban: AL34202510020000001401699476

4.3 Kalimi i pronesise se kutoave behet ne momentin e likujdimit te vleres se shitjes percaktuar ne nenin 4.2 dhe me depozitimin e akteve prane QKB.

**Neni 5**

**Zgjidhja e Kontratës**

5.1. Kontrata do të konsiderohet e zgjidhur në rast se bleresi nuk paguan vleren e shitblerjes se kuotave ne llogarine bankare te shitesve brenda nje afati 10 ditor. Mandati Bankar verteton realizimin e pageses.

**Neni 6**

**Transferimi i të Drejtave**

6.1. Me likujdimin e vleres se shitblejres, regjistrimin e akteve ne Qendren Kombetare te Biznesit, te gjitha te drejtat dhe detyrimet kalojne ne favor te pales Blerese.

6.2 Asnjëra nga palët nuk mund të transferojë, tërësisht ose pjesërisht, detyrimet e tij sipas kontratës, ne favor te paleve te treta.

**Neni 7**

**Interpretimi i Kontratës**

7.1 Çdo shtese, ndryshim, zgjidhje ose heqje dore nga ndonje prej dispozitave te kesaj Kontrate, do te jete e vlefshme vetem nese behet me shkrim, me akt noterial dhe nenshkruhet nga ose ne emer te seciles Pale.

7.2 Ne rast se nje dispozite ose detyrim sipas kesaj Kontrate eshte i pavlefshem, i paligjshem ose i pazbatueshem ne nje juridiksion, vlefshmeria, ligjshmeria dhe zbatueshmeria e dispozitave ose detyrimeve te tjera, ose e ketyre dispozitave ose detyrimeve ne nje juridiksion tjeter, nuk do te preket nga nje fakt i tille.

7.3 Palet do te perpiqen te zevendesojne nje dispozite te pazbatueshme ose te pavlefshme, ne masen me te madhe te mundshme, per te arritur qellimin e kesaj dispozite.

**Neni 8**

**Baza Ligjore**

8.1. Kontrata hartohet dhe interpretohet sipas dispozitave te Kodit Civil dhe Ligjit Nr. 9901/2018 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare".

**Neni 9**

**Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve**

9.1. Blerësi dhe Shitësit angazhohen të bëjnë çdo përpjekje të zgjidhin mosmarrveshjet ose konfliktet e ndodhura midis tyre ose në lidhje me këtë marrveshje me negociata direkte.

9.2. Nëse palët dështojnë në zgjidhjen e mosmarrveshjes ose konfliktit ndërmjet tyre, problemet do të mundohen të vlerësohen me anë të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve sipas kontratës dhe procedurave juridike në fuqi sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë.
9.3. Në rast të konflikteve gjyqësore, Gjykata kompetente do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

**Neni 10**

**Dispozita të fundit**

10.1 Kjo marrëveshje është përpiluar në katër kopje, dhe pas nënshkrimit të saj nga palët secila prej tyre merr nga një kopje, një kopje depozitohet në Qëndrën Kombëtare të Biznesit në Shqipëri.

**Shitësi**

**Z. Eduard CURRAJ**

**Z. Dorian SADIKU**

**Dhenese Pelqimi**

**Znj. Marjana CURRAJ**

**Znj. Jorida JUBANI**

REPUBLIKA E SHQIPERISE DeltaMed L78513201T TEL: +355 222 435 78 SHKODER Distributor FARMACEUTIK

**Blerësi**

**Shoqëria Tregtare "Pharma One" sh.p.k.**

**Z. Ben PETANI**

**Administrator**

**NOTER**

NOTER GJERGJ KONGOLI

Rr. e Dibres, Qendra e Biznesit AK,
"Selvia", Kati V
TIRANE, SHQIPERI
TEL/FAX.:355 4 2420005
TEL:355 4 2420006
Email: rbs@roen-al.com

Regjistri i Barrëve Siguruese

## REZULTATET E KËRKIMIT

| | |
|---|---|
| Numri i Rezultatit te Kerkimit: | D-20200226114348175 |
| Data e Rezultatit te Kerkimit: | 26.02.2020 |
| Ora e Rezultatit te Kerkimit: | 11:43:48AM |
| Lloji i Kerkimit: | |
| Numri i Dokumentit: | D-400-585-3052 |
| Referenca e Perdoruesit: | |

**LISTA E PERSONAVE ME REZULTAT KERKIMI 0**

DELTA MED SH.P.K.

REGJISTRI I BARREVE SIGURUESE R.B.S. TIRANË - ALBANIA

**VENDIMI I MBLEDHJES SE ASAMBLESE SE ORTAKEVE**

**TE SHOQERISE DELTA Med Shpk**

Sot, ne Tirane me date 27/02/2020 Asambleja e Ortakeve te Shoqerise e perbere nga:

**Z. Eduard CURRAJ,** shtetas shqiptar, i biri i Gjonit, i datëlindjes 13.10.1973, lindur ne Shkoder dhe banues në Tirane, me adresë Rruga e Kavajes,_E4,Shk.5 person madhor e me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit nr. H31013028R, në cilësinë e Ortakut të Shoqërisë "DELTA Med" sh.p.k., zotërues në masën 50 % të kapitalit të shoqërisë,

**Z. Dorian SADIKU,** shtetas shqiptar, i biri i Tahirit, i datëlindjes 20.06.1979, lindur Shkoder dhe banues në Tirane, me adresë _Bulevardi Gjergj Fishta Pallati Selmani, person madhor e me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit nr. H90620115D, në cilësinë e Ortakut të Shoqërisë "DELTA Med" sh.p.k., zotërues në masën 50 % të kapitalit të shoqërisë.
Mbledhja e Asamblese se Ortakeve, ne baze , e mbledhur rregullisht, ne baze te Statut te Shoqerise "DELTA Med" Shpk, dhe ne baze te *Ligjit Nr.9901/2018, i ndryshuar, "Për tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare"* me pjesëmarrjen e te ortakeve, zotërues te 100% te pjesëve te kapitalit, te cilet shqytuan:

**Rendin e Dites:**

- *Transferimin me ane te shitjes se pjesëve te kapitalit, 1 kuote qe perben 50 % të pjesëve të kapitalit themeltar , te zotëruar nga Z. Eduard CURRAJ në shoqërinë tregtare "DELTA Med" Sh.p.k., regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit me NIPT L78513201T ne favor te Shoqërisë "Pharma One" Shpk*

- *Transferimin me ane te shitjes se pjesëve te kapitalit, 1 kuote qe perben 50 % të pjesëve të kapitalit themeltar , te zotëruar nga Z. Dorian SASIKU në shoqërinë tregtare "DELTA Med" Sh.p.k., regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit me NIPT L78513201T, ne favor te Shoqerise "Pharma One" Shpk*

Mbledhja pasi mori ne shqyrtim rendin e dites, palet shitese bien dakord te heqin dore nga e drejta e parablerjres, dhe vendosin:

**<u>V E N D O S I</u>**

1. Miratimin e rendit të ditës:
2. *Transferimin me ane te shitjes se pjesëve te kapitalit, 1 kuote qe përben 50 % të pjesëve të kapitalit themeltar , te zotëruar nga Z. Eduard CURRAJ në shoqërinë tregtare "DELTA Med" Sh.p.k., regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit me NIPT L78513201T ne favor te Shoqërisë "Pharma One" Shpk, ne vlerën prej* **<u>32.381.835,00 Leke (tridhjete e dy miljon e treqind e tetedhjete e njemije e tetëqind e tridhjete e pese leke)</u>**, *vlere e cila do te depozitohet ne llogarinë bankare* te shitësit

   **<u>Eduard Gjon Curraj</u>**

   **Banka: -Raiffesen Bank sh.a.**

   **Nr. i Llogarisë: 1401133488**

   **Iban: AL392025100200000 1401133488**

3. *Transferimin me ane te shitjes se pjesëve te kapitalit, 1 kuote qe përben 50 % të pjesëve të kapitalit themeltar , te zotëruar nga Z. Dorian SADIKU në shoqërinë tregtare "DELTA Med" Sh.p.k., regjistruar në Qëndrën Kombëtare të Biznesit me NIPT L78513201T, ne favor te Shoqërisë "Pharma One" Shpk, ne vlerën prej* **<u>32.381.835,00 Leke (tridhjete e dy miljon e treqind e tetedhjete e njemije e tetëqind e tridhjete e pese leke)</u>**, *vlere e cila do te depozitohet ne llogarinë bankare* te shitësit

   **<u>Dorian Tahir Sadiku</u>**

   **Banka: -Raiffesen Bank sh.a.**

   **Nr. i Llogarise: 1401699476**

**Iban: AL34202510020000001401699476**

Për sa sipër, mbyllet, mbledhja e Asamblesë se Ortakeve, te cilët e nënshkruajnë, Vendimin e Asamblesë, duke vene emrin dhe mbiemrin e tyre.

**PER SHOQERINE "DELTA Med" Shpk**

**Ortaket**

**Z. Eduard CURRAJ** **Z. Dorian SADIKU**

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DeltaMed Shpk
L78513201T
TEL: +355 222 435 78
SHKODER
Distributor FARMACEUTIK

DHOMA E NOTERISE TIRANE
NOTER
GJERGJ KONGOLI

**REPUBLIKA E SHQIPERISË**

**DHOMA E NOTERISË TIRANË**

**Nr. 965 Rep.**

## VËRTETIM NËNSHKRIMI

Ne Tirane, sot me date 27/02/2020 (dymijë e njëzet), para meje Noterit Gjergj Kongoli, anëtar i Dhomës se Noterëve Tirane, u paraqitën personalisht shtetasit:

- **Eduard Curraj**, lindur me 13.10.1973 ne Jeran, Shkodër dhe banues ne Tirane, identifikuar Pasaportë nr. BF9167537/H31013028R, madhor e me zotësi te plote juridike për te vepruar.
- **Dorian Sadiku,** i biri i Tahirit, lindur me 20.06.1979 ne Shkodër dhe banues ne Tirane, identifikuar me pasaportë me nr. BF5378227 dhe numër personal H90620115D

Te cilët më deklaruan se, në cilësinë e Ortakëve të Shoqërisë 'Delta Med' shpk, kanë redaktuar jashtë kësaj zyre noteriale Vendimin e Mbledhjes së Asamblesë të Përgjithshme të Ortakëve të datës 27/02/2020, shkresë të cilën e nënshkruan rregullisht në prezencën time.

Unë, Noteri, vërtetoj rregullsinë dhe bazueshmërine e redaktimit ne ligj të këtij vërtetimi si dhe autenticitetin e nënshkrimit, me cilësinë që më njeh Ligji nr. 110 datë 20.12.2018 "Për Noterinë" në Republikën e Shqipërisë.

Pulla e taksës u pagua

**NOTER**

**GJERGJ KONGOLI**